



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2016
Nr. ref.: RK 936/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI76/15

Parashtrues

Dušana Mitić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0114-A0001, të 11 dhjetorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga znj. Dušana Mitić-Simić nga fshati Llapna Sellë, komuna e Graçanicës (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga z. Visar Vehapi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0114-A0001 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), të 11 dhjetorit 2014, i cili i ishte dorëzuar parashtrueses së kërkesës më 12 shkurt 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 11 qershor 2015, parashtruesja e dorëzoi kërkesën me postë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e cila u pranua në Gjykatë më 15 qershor 2015.
6. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 4 shtator 2015, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit.
8. Më 16 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 21 prill 2008, parashtruesja e kërkesës parashtrroi padi në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar), për anulimin e kontratave të blerjes për dy parcela kadastrale që gjenden në Llapna Sellë.
10. Parashtruesja e kërkesës pretendoi se kontratat e shitjes së këtyre parcelave janë nënshkruar nën tryshnjë e autoriteteve shtetërore të asaj kohe.

11. Më 20 qershor 2013, Kolegji i Specializuar (Aktgjykimi SCC-08-0105) e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtrueses së kërkesës.
12. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi, thuhet se *“Paditësja i ka bazuar veprimet e veta në nenin 103 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 dhe nenin 8A të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme të vitit 1981. Megjithatë, neni 1106 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë eksplicite e përjashton efektin retroaktiv të dispozitave ligjore, prandaj nuk mund të zbatohet për tapitë e 1960-ës të lidhura nga paraardhësja e paditëses (...) Kur jemi te neni 8 i Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme, gjykata është e mendimit se ky ligj asnjëherë nuk ka qenë në fuqi në Kosovë. Ligji ishte miratuar më 1981 në Serbi nga Kuvendi i Serbisë (Gazeta zyrtare e Serbisë 45/81) dhe në të njëjtin vit në Kosovë nga Kuvendi i Kosovës (Gazeta Zyrtare e Kosovës (45/81). Që të dy ligjet kanë titullin "Ligji mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme. Më 23.07.1987 ligjvënësit e Serbisë e ndryshuan ligjin sa i përket nenit 8a. Legjislativi i Serbisë gjithashtu nuk kishte fuqi të ndryshoj ligjet e një legjislativi tjetër. Pra, Ligji i Kosovës mbi Qarkullimin kurrë nuk e kishte përvetësuar dispozitën si neni 8 i ligjit të Serbisë”*.
13. Më 11 korrik 2013, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë për shkak të: *“shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, verifikimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të të drejtës materiale”*.
14. Më 11 dhjetor 2014, Kolegji i Apelit e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar.
15. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së deklaroi:

“... Kolegji i Ankesave konkludon njejtë si gjykata e shkallës së parë se Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 dhe nenin 8A të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme të vitit 1981. Megjithatë, neni 1106 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë eksplicite e përjashton efektin retroaktive të dispozitave ligjore, prandaj nuk mund të zbatohet për tapitë e 1960-ës të lidhura nga paraardhësja e paditëses (...). Ndryshimet e këtij neni Serbia i kishte bërë njëanshëm pas vitit 1987 përkundër faktit se ajo ende nuk kishte fuqi legjislative për të ndryshuar ligjet e në Kosovë, andaj ajo dispozitë nuk ka qenë e vlefshme asnjëherë në Kosovë, pos kur përfundimisht ishte suprimuar autonomia substanciale e Kosovës”.
16. Për më tepër, Kolegji i Apelit gjeti se *“ligji i zbatueshëm lidhur me kërkesat e tilla është Ligji i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 04/L-033, i cili në nenin 11, paragrafi 2, e zgjidh dilemën e kërkesave të tilla”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtat e saj për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe rrjedhimisht për mbrojtjen e pronës.

18. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit e privoi atë nga e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak se *“ka nxjerrë aktgjykime krejtësisht politike dhe jo juridike, nga se nuk është në kompetencën e Gjykatës që të merret me shfuqizimin e ndonjë ligji, (...) nga se nuk është në kompetencën e Gjykatës që të merret me shfuqizimin e ndonjë ligji”*.
19. Parashtruesja e kërkesës, më tej, pretendon se Kolegji i Apelit *“ka shkelur edhe nenin 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (...) e ka trajtuar në mënyrë të pa barabartë përpara ligjit në krahasim me atë mijëra praktika gjyqësore përpara vitit 1999 dhe ato mijëra të tjera pas vitit 1999”*.
20. Përveç kësaj, parashtruesja konkludon se *“duke i shkelur dispozitat e lartcekura DHPGJSK-ja e ka shkelur edhe nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës e cila e garanton mbrojtjen e të drejtës së pronës”*.
21. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata *“TA SHPALL të pavlefshëm”* aktgjykimin e kontestuar dhe *“të kthejë Aktgjykimin (...) për rishqyrtim”*.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
24. Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.
25. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.
2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se: [...] (d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”*.
26. Gjykata rikujton se argumenti kryesor i parashtrueses ka të bëjë me zbatueshmërinë e nenit 8 a) të Ligjit për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme

të Republikës së Serbisë “në tërë territorin e Republikës së Serbisë, çka do të thotë se ka qenë në aplikim edhe në Kosovë”.

27. Në të vërtetë, parashtruesja pretendon se “dispozitat e caktuara (në atë kohë) janë rregulluar në mënyrë unike sipas nenit 300 të Kushtetutës së Serbisë për tërë territorin e ish Republikës, - çka do të thotë edhe të ish KSAK. dhe atë për të u pru një dispozitë e tillë dhe për të aplikuar edhe ish KSAK”.
28. Gjykata vlerëson se Kolegji i Apelit kishte analizuar tërësisht pretendimet e bëra nga parashtruesja e kërkesës, duke arsyetuar në mënyrë të hollësishme se pse ankesa e saj ishte refuzuar si e pabazuar.
29. Në të vërtetë, Kolegji i Apelit shpjegoi se “Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 dhe nenin 8A të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme të vitit 1981. Megjithatë, neni 1106 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë eksplicite përjashton efektin retroaktiv të dispozitave ligjore, prandaj nuk mund të zbatohet për tapitë e 1960-ës të lidhura nga paraardhësja e paditëses”.
30. Për më tepër, Kolegji i Apelit konkludoi më tej se “në rastin konkret nuk ka pasur asnjë kundërshti ndërmjet ligjit të Kosovës dhe të Serbisë”.
31. Gjykata konsideron se pretendimi për zbatimin e gabuar të dispozitave të caktuara ligjore në vend të tjerave ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë, e cila bie nën prerogativat e gjykatave të rregullta. Për më tepër, ky pretendim përbënë një parashtrësë ankimore të “shkallës së katërt”.
32. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për atë sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria) (Shih, për shembull, Rasti nr. KI72/14, parashtruesja e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, para. 65).
33. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM]*, Nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
34. Gjykata Kushtetuese rikujton se roli i saj është vetëm që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, po ashtu *mutatis mutandis* në Rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
35. Gjykata rithekson se, si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë çështje vetëm për instancat e rregullta, të gjeturat dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë të detyrueshme për Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, kur një vendim i një gjykate të rregullt është qartazi

arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta vë atë në pikëpyetje (Shih *Sisojeva dhe të tjerë kundër Letonisë* [DHM], kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, para. 89).

36. Gjykata konsideron se procedurat para Kolegjit të Apelit nuk ishin arbitrare; procedurat ishin të drejta dhe aktgjykimi ishte plotësisht i justifikuar dhe i arsyetuar, përkatësisht shpjegon se pse legjislacioni në të cilin thirret parashtruesja e kërkesës nuk është i zbatueshëm në rastin e saj (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, KEDNJ, vendim i 30 qershorit 2009).
37. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka ndërtuar pretendimet e saj mbi baza kushtetuese. Në të vërtetë, parashtruesja nuk ka mbështetur dhe dëshmuar se Kolegji i Apelit ia kishte mohuar asaj të drejtat, kur ka vendosur se përjashtohet fuqia prapavepruese.
38. Përkundrazi, Gjykata vëren se parashtruesja e bazoi ankesën e saj në “*aplikim të gabuar të së drejtës materiale – ligjit*”, që ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si e tillë nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.
39. Përveç kësaj, fakti se parashtruesja nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrëjë vetvetiu një pretendim të argumentueshëm për shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.
40. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetutese dhe është e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) d) dhe 2) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 mars 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi